

## QASJE NË METODOLOGJINË E TË MËSUARIT TË LËNDËVE FETARE ME LËNDËT SHOQËRORE NË MEDRESETË SHQIPTARE

Duke gërshetuar dhe ndërthurur lëndët fetare me lëndët shoqërore, prej medreseve tona, në vijimësitë viteve, janë përgatitur kuadro me erudicion e nivele të larta intelektuale dhe kulturore. Ata kanë dhënë ndihmesë të çmuar si në sferën e institucionit të besimit ku janë angazhuar, ashtu edhe në fushën e veprimtarisë shoqërore. Në kuptimin dhe konceptimin e njohurive që merren nëpërmjet lëndëve humane, nxënësit që kalojnë nëpërmjet bankave të medreseve dallohen esencialisht prej masës së nxënësve me formim laik. Medresisti, botën, tokën ku jeton në tërësinë e aspektit fizik dhe ekonomik si dhe në kompleksitet të të gjitha dukurive shoqërore në çdo kohë e në çdo vend ku kanë ndodhur, i percepton dhe i kupton si shprehje të ligjeve dhe vullnetit suprem.

Duke qenë se lëndët fetare dhe ato humane në medresetë tona si objekt formimi kanë të njëjtin nxënës, ato përjasen me njëra-tjetrën në qëllime edhe pse diferencohen në kurrikula. Është e kuptueshme se kurrikulat e lëndëve humane drejtohen, përgatiten e kontrollohen nga shteti dhe institucione të ndërtuara në formë piramidale nga baza deri në majë. Programet dhe tekstet shkollore si komponentët më esencialë të kurrikulës shkollore hartohen me grupe specialistësh dhe para implementimit i nënshtrohen shqyrtimeve, analizave dhe një diskutimi të gjerë në përfshirje të atyre që do t'i zbatojnë këto kurrikula. Njëherazi, edhe metodat e të mësuarit si pjesë e kurrikulave menaxhohen dhe instruktohen nga institucione të specializuara. Tekstet mësimore janë të pajisura me aparat të mirëstudiuar pedagogjik. Ato janë të pajisura me pyetje e detyra të karakterit formues, me harta, tabela, ilustrime që realizojnë të mësuarit konkret, praktik, problemor dhe lehtësisht të kuptueshëm. Për t'u aftësuar dhe kualifikuar në vënien në zbatim të kurrikulave, mësuesit e lëndëve humane kanë në dispozicion, një arsenal të konsiderueshëm pedagogjik dhe didaktik. Natyrshëm lindin pyetjet: Po mësuesit e lëndëve fetare a e disponojnë këtë arsenal? Po programet dhe tekstet e lëndëve fetare a e

disponojnë këtë performancë?

Në reagim ndaj këtyre pyetjeve padyshim arrihet në domosdoshmërinë e qasjeve të kurrikulave midis këtyre dy profile lëndësh. Duke folur për kontributin e mësuesit islam Haki Sherafi në fushën e didaktikës, Prof. Ramiz Zekaj thekson:

*“Me këto tekste ai na dha një shembull mjaft pozitiv si duhen hartuar ato dhe në ç’raport duhet të jetë mësuesi me nxënësin. Natyrisht është e kuptueshme se në kohën tonë ka dhe probleme të tjera në përputhje me rrethanat që kalon shoqëria jonë, e cila kërkon tekste mësimore sa më shkencorë e të përsosur për edukimin fetar të myslimanëve të vegjël”.<sup>1</sup>*

## Metoda, fener ndriçues në rrugëtimin e gjatë drejt dijeve

Tradicionalisht, metoda didaktike me shtrirje dhe përdorim më të gjerë është ajo e shpjegimit, dhe posaçërisht në ato tema mësimi që përmbajnë krejtësisht njohuri të reja dhe të panjohura për nxënësin. Novacioni didaktik konsiston në praktikën e mësuesit për t’iu larguar shablloneve të vjetëruara e shpjegimit mot-a-mot, fjalë për fjalë, përmendësh dhe për ato çështje që nxënësi mund t’i kuptojë vetë. Mësuesit, edhe ata të lëndëve fetare i gjejmë të angazhuar në përballje me këtë model mësimdhënieje. Për metodën e mësuesit të Medresesë së Përgjithshme në Tiranë, Haki Sharafi, një nxënës i tij shkruan:

*“Mësimi nuk kufizohet vetëm në shpjegimin e temës së caktuar. Me shembujt e gjetur kishte vazhdimisht fjalë të urta të popullit, aforizma, citate më përmbajtje morale e patriotike”.<sup>2</sup>*

Shumë didaktë bashkëkohorë e vendosin theksin te metodat problemore në mësimdhënie:

*“Situata problemore ka specifikën e saj në çdo klasë e temë mësimore. Ajo dallon për funksionet e saj nxitëse, stimuluese, rregulluese e drejtuese, të cilat nëse nuk përdoren me mjeshhtëri*

1 Prof. Dr. Ramiz Zekaj. “Edukata fetare e morale në tekstet shkollore të Haki Sharafit”. Libri Haki Sharafi dhe vepra e tij, Tiranë, 2000, faqe 71.

2 Ismail Muçaj. “Çfarë di dhe zotëroj nga gjuha dhe letërsia e kam prej profesorit të nderuar Haki Sharafi”. Libri Haki Sharafi dhe vepra e tij, Tiranë, 2000, faqe 77.

*mund të shndërrohen edhe në të kundërtën e tyre*”.<sup>3</sup>

Mësuesit e lëndëve shoqërore synojnë përdorimin e metodës së bisedës dhe diskutimit në mësimdhënie, duke arritur në një farë mase edhe aktivizimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve në proces. Nxënësit e shkollës së mesme, në ciklet e mëparshme të shkollimit janë stërvitur deri diku me këtë model të mësimi. Mësuesi i shkollës së mesme mund të mbështetet në përvojën e fituar nga nxënësit për ta ngritur në një stad më të lartë këtë praktikë.

*“Të menduarit krijues është mjaft i gjerë dhe i shumanshëm në çdo lëndë e në tërësi në procesin mësimor e në raport më të drejtë midis të menduarit konkret dhe atij logjik, duke i dhënë gradualisht peshë me rritjen e moshave shkollore”.*<sup>4</sup>

Profesori i mirëpritur dhe emblemë në shkollën shqiptare “Aleksandër Xhuvani”, në vështrim të metodave të përdorura në mësim, vlerësonte metodën induktive, në mënyrë që procesi mësimor të mos mbetet i thatë dhe anemik. Për praktikën e mësimdhënies nga Prof. Aleksandër Xhuvani, ka shkruar pedagogu dhe didakti i shquar Prof. Dr. Shefik Osmani:

*“Duke vlerësuar drejt raportin e lidhjes mes lëndëve (lidhjen ndërlëndore, B.T.) dhe në të njëjtën kohë specifikkën që ka njëra apo tjetra, ai theksonte që në varësi të moshës, të rrethanave, ecuria e mësimi ka veçoritë e veta sipas specifikkës së lëndës. Ai theksonte se nuk ekziston një metodë e përgjithshme. Ai që për metodën induktive në histori-geografi, edukatë qytetare, kurse atë deduktive në lëndët me karakter shkencor”.*<sup>5</sup>

Edhe në mësimdhënien e lëndëve fetare në medresetë shqiptare gjendet përvojë pozitive dhe e dobishme në përdorimin e metodave aktive, praktikë që i japin dimension të ri bagazhit që fitojnë nxënësit në këto lëndë:

*“Natyra e lëndëve që zbatohen në medresenë “Isa Beu” imponon përdorimin e metodave të shumëllojshme. Për sa kohë që tek njëra*

3 Kol Tahiri, Zana Gjeçi. “Revista pedagogjike” Nr. 9, 1998, artikulli: “Të mësuarit problemor, mjet dhe rrugë efektive në luftë kundër të mësuarit mekanike passive”, faqe 47.

4 Telemak Xhaxho, Ylli Pango. “Revista pedagogjike” Nr. 3, 1998, faqe 42. Artikulli: “Për një konceptim më të drejtë të rolet të të menduarit logjik, krijues, në procesin për përvetësimin aktiv të njohurive”.

5 Prof. Dr. Shefik Osmani “Revista pedagogjike” Nr. 2, 1980, faqe 57. Artikulli “Didakti ynë Aleksandër Xhuvani dhe didaktika shqiptare”.

*lëndë dominon metoda verbale, tek tjetra dominon ajo tekstuale dhe për sa kohë që të ndonjë lëndë apo njësi mësimore dominon metoda e monologut, tek tjetra dominon ajo e dialogut. Ka lëndë që janë thjesht teorike, si ajo e Akaidet (besimit), por ka lëndë që janë edhe praktike si ajo e Kur'anit dhe Fikhut. Andaj përderisa në lëndët Akaidit, Tefsiret, Hadithet etj., dominon metoda e monologut dhe ajo e dialogut, në variantet tyre, vërejmë se në lëndën e Kur'anit dhe në pjesë të mëdha të Fikhut dominon metoda tekstuale dhe ajo praktike”.<sup>6</sup>*

Në shumë faqe librash dhe revistash të natyrës mësimore ndër vite gjejmë edhe argumente mbi superioritetin e metodave të reja të diskutimit, debatit, të mësuarit problemor ndaj të mësuarit tradicional. Jo vetëm si orientim, por këtë epërsi e ndeshim edhe në praktikën e mësimdhënies.

*“Megjithatë të mësuarit problemor nuk duhet absolutizuar. Edhe praktika botërore ka vërtetuar se çdo lloj apo formë racionale e organizimit të procesit mësimor, si tradicionale ashtu edhe e re, është efektive kur përdoret në lidhje të ngushtë dhe në unitet organik me të tjerat.”<sup>7</sup>*

Në lëndët humane gjejmë hapësirë dhe mundësi nxënësit që të aktivizohen dhe të jenë kontribues me aq sa dinë, në çdo moment dhe etapë të orës së mësimt, si në hyrje, në kontrollin e dijes, në prezantimin e njohurive të reja dhe në mbyllje. Gjithashtu, sipas natyrës së lëndës dhe temës mësimore, gjenden rrugët dhe mundësitë për angazhimin e nxënësve në punë të pavarur dhe aktivitet krijues, si demonstrim i mendimit krijues dhe të pavarur. Në lëndët humane, në orën e mësimt rezervohet më shumë kohë që nxënësi të shpallë idetë dhe mendimet për atë që shtrohet për diskutim. Noti mësohet duke u kredhur në ujë dhe jo duke bërë leksione për notin. Duke i dhënë më shumë kohë nxënësit që të flasë dhe veprojë në orën e mësimt, mësuesi pushon së qenuri “një llafazan që edukon nxënës memecë”.

*“Kur mësuesi i historisë ose i gjeografisë zgjedh metodat që do të përdorë në këtë proces, duhet të ketë parasysht edhe nivelin e afërsive*

6 Prof. Dr. Naser Ramadani. “Kurrikulat dhe tekstet shkollore në medresetë shqiptare”, Tiranë, 2018. Artikulli: “Metodat e mësimdhënies midis traditës dhe modernes në medresenë “Isa Beu Shkup”, faqe 121.

7 Luan Harago, Pëllumb Gaçe. “Revista pedagogjike” Nr. 3, 1988, faqe 29. Artikulli: “Probleme psiko-pedagogjike të të mësuarit aktiv krijues”.

të nxënësve dhe përvojën e tyre personale. Në qoftë se materiali i ri nuk njihet, atëherë metoda kryesore duhet të jetë shpjegimi dhe demonstrimi, por në qoftë se nxënësit kanë disa njohuri për materialin, mësuesi përdor metodën e bisedës, ndërsa kur materiali nuk është i vështirë dhe nxënësit kanë fituar disa shkathtësi e shprehi, mund të përdoret metoda e punës së pavarur me librin. Pra, nxënësit të studiojnë materialin e ri në mënyrë të pavarur”.<sup>8</sup>

Edhe në lëndët fetare në medresetë shqiptare shpalosen ide pedagogësh mbi rrugët dhe mundësitë e kthimit të nxënësit në subjekt aktiv në mësim.

*“Objektivat dhe rezultatet e mësimit gjithmonë përshkruajnë punën finale, gjegjësisht rezultatet e dëshiruara, ndërsa aktivitetet mësimore, ndjekja e ligjëratës dhe shpjegimet që bëjnë mësuesi në klasë, mbajtja e një hytbe në ndonjë xhami apo prezantimi i ndonjë ligjërate janë mënyra me të cilat arrihen deri tek objektivat si dhe janë patjetër pjesë e procesit mësimor”.*<sup>9</sup>

Koncepti tradicional i të mësuarit është përshkruar më së miri nga Çarl Dikens në librin “Kohë të vështira” kur shkruan se

*“...nxënësi konsiderohet si një enë që duhet mbushur plot e përplot. Ndërsa mësuesi si një person që zotëron njëkohësisht njohuri dhe vlera që duhet t’ua mësojë ato gradualisht nxënësve. Prej kësaj rrjedh roli pasiv i nxënësit në lidhje me lëndën që mëson dhe mësuesin që e mëson”.*<sup>10</sup>

Për rolin e mësuesit në metodën e mësimdhënies shprehet qartësisht Rusoi:

*“Metoda nuk është simite që e nxjerr furrxhiu nga furra”.*

Kjo do të thotë se mësuesi duhet ta nxjerrë vetë simiten nga zjarri dhe ndoshta duke përcëlluar edhe duart. Mësuesit e pazotë le të mësojnë nga ata që janë mjeshtrë në nxjerrjen e simiteve nga furra.

8 Wilson Kuzi. “Revista pedagogjike” Nr. 3, viti 1978, faqe 99. Artikulli: “Ngritja e nivelit shkencor të mësimdhënies së historisë e gjeografisë kërkon metoda efikase”.

9 Prof. Dr. Shaban Sulejmani, Dr. Argëtim Saliu, Mr. Sci. Salim Sulejmani. “Kurrikulat dhe tekstat shkollorë në medresetë shqiptare”, Tiranë, 2018. Artikulli: “Kurrikulat e lëndëve fetare islame”, faqe 111.

10 Dr. Bashkim Peçi: “Administrimi dhe menaxhimi i arsimit”, Tiranë, 2004. Artikulli: “Teoritë dhe metodat e të mësuarit”, faqe 41.

## Cili është barometri matës i aftësive të mësuesit?

Shigjetën e këtij barometri e lexojmë më ekzaktesisht në momentin e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive të nxënësit, që është momenti më i vështirë dhe më delikat në profesionin e mësuesisë. Duhet kuptuar se qëllimi i kontrollit nuk është nota, dhe nota nuk është pagë me medalje. Qëllimi kryesor i kontrollit është vështrimi në thellësi dhe perspektivë të rrugëtimit të nxënësit drejt dijes. Një vlerësim i drejtë ndikon që nxënësi të jetë optimist dhe jo të humbasë besimin në forcat e veta. Një vlerësim i gabuar e topit vullnetin dhe dëshirën e nxënësit për të mësuar. Nuk duhet harruar si në këtë proces, nxënësi formon opinionet dhe konsideratat për mësuesin. Janë mëse të zakonshme ankesat e nxënësve për vlerësimin nga ana e mësuesit, si mësuesi më hëngri notën, mësuesi më ka inat, mësuesi mban me hatër, mësuesi është dorështrënguar, mësuesi të kërkon mësimin përmendësh etj. Pavarësisht subjektivitetit që mbartin këto vlerësime të nxënësve, ka vend për përmirësime në këtë drejtim dhe jo më kot pedagogu Uotson ka dhënë këshillën: “*Mësues, korrigjoni veten tuaj!* Në një anketë të zhvilluar me nxënësit e shkollës sonë rreth mendimeve të tyre për vlerësimin e njohurive nga ana e mësuesve, nuk munguan konsideratat. Kështu ata u shprehën : “Mësuesi na nxit që jo t’i themi mësimet përmendësh, por së pari të kuptojmë. Ai na i bën mësimin të lehtë e të kuptueshëm. Mësuesi i historisë më shumë na ushtron ne të flasim se sa ai flet vetë, mësuesi i letërsisë na kërkon që ato që mësojmë t’i zbatojmë në praktikë, mësuesi i gjeografisë e vendos majën e shkopit tregues në një pikë të hartës pa na bërë asnjë pyetje (vetë ne formulojmë pyetjen dhe japim përgjigjen)”. Nuk munguan dhe opinione, shqetësime, pakënaqësi nga nxënësit në këtë aspekt të punës së mësuesit. Anketat anonime iu dhanë mësuesve për t’i lexuar. Konkluzioni është se nxënësit na dhanë një leksion të qartë që nuk mund ta përmirësojmë dhe perfeksionojmë metodën dhe stilin tonë në mësimdhënie pa vjelur sistematikisht opinionet dhe mendimet e nxënësve.

Dijet janë një depo e madhe dhe pyetjet janë çelësat për të hyrë në këtë depo

Nga një teolog kam dëgjuar krahasimin se dijet janë një pus i thellë, ndërsa pyetja është kovë për të nxjerrë ujë nga ky pus. Metodën e të pyeturit e gjejmë në prolektikën e përditshme të njeriut për të zbuluar ato dije të nevojshme për jetën e tij. Prandaj jo më kot ka lindur fjala e mençur e popullit “Me të pyetur gjen Stambollin dhe kush pyet nuk humbet”.

Sokrati i Greqisë antike, gati 2500 vjet më parë, nëpërmjet pyetjeve hidhte poshtë të pavërtetat dhe i ndihmonte nxënësit të shkonin tek e vërteta. Prandaj ka mbetur dhe shprehja “pyetje sokratike”, p.sh. :- çfarë është njeriu? - Një dykëmbësh, -përgjigjen nxënësit. - Po gjeli a është njeri? – vazhdon pyetjen Sokrati dhe nxënësit duhet të vrasin mendjen për ta gjetur përkufizimin e saktë të nocionit njeri.

Të pyeturit e vetvetes ka çuar mendjet e zgjuara në zbulimin e ligjeve të mëdha shkencore. Arkimedi i bëri pyetjen vetes: Pse sfungeri i zhytur në ujë del mbi sipërfaqe? Njutoni i bëri pyetjen vetes: Pse kokrra e mollës ra nga dega? Nuk mungojnë edhe përgjigje naive ndaj pyetjeve. Pse bien tërmetet?- u bë kurioz njeriu i lashtë. - Sepse bualli e hedh tokën nga njëri bri tek tjetri. - Përse na duhet hunda?- pyet Emili i Rusoit, mësuesen Gertrudë. - Për të mbajtur syzet,- përgjigjet Gertruda. Në një kohë kur hoxha Hasan Tahsim ishte në fshatin e tij në Ninat, ndodhi eklipsi i hënës. Fshatarët për këtë fenomen pyetën një fanatik, i cili tha se hënën e ka zënë shejtani dhe fshatarët nuk morën gurë të vegjël sa kokrra e lajthisë për të goditur shejtanin, por kapën dyfekët dhe filluan të qëllonin drejt hënës. - E keni të kotë, - u tha Hasan Tahsimi, - Hëna është shumë larg dhe nuk shkojnë dot deri atje plumbat e dyfekëve tuaj. Midis Hënës dhe Diellit ka dalë në mes Dheu. Një didakt i sprovuar dhe i suksesshëm në mësimdhënie u bën pyetje nxënësve që mbështetur në atë që ka dëgjuar të gjejë përgjigjen. Pyetjet, njëherazi, janë praktikë e mësuesit për të verifikuar dhe vlerësuar dijet e nxënësve në disiplinën që ai zhvillon. Disa didaktë pretendojnë se nëpërmjet pyetjeve ndaj nxënësve mësuesi kontrollon vetveten në profesion. Në një tekst didaktik autorët shkruajnë:

*“Të nderuar mësues, të pyeturit qëndron në themel të komunikimit masiv në përgjithësi, dhe atij mësues-nxënës në veçanti. Ai është një proces me të cilin mësuesit dhe nxënësit përballen çdo ditë. Qysh në kohët e lashta Sokrati udhëheq nxënësit e tij drejt zbulimit të të vërtetave. Përmes kapitujve të ndryshëm, grupi i autorëve është përpjekur t’u japë përgjigje pyetjeve të ndryshme lidhur me të pyeturit: Pse pyesin njerëzit? Pse pyesin mësuesit? Çfarë duhet të kemi parasysh kur pyesim? A duhet të jetë të pyeturit monopol vetëm i mësuesit? Si ndihmon të pyeturit në zhvillimin e mendimit kritik e krijues të nxënësve? Si mund t’i nxitni nxënësit për të pyetur? Cilat janë teknikat për hartimin e një pyetjeje efektive? Pikërisht me këtë shqetësim, grupi i hartuesve guxoi t’i futej punës për përgatitjen e këtij doracaku për mësuesit e lëndëve Anglisht,*

*Frëngjisht, Histori, Gjeografi dhe Edukatë qytetare*.<sup>11</sup>

Do iu rekomandojmë drejtuesve të medreseve ta aplikojnë këtë pyetësor. Duke qenë se në medresetë gjejmë tekste me mangësi në drejtim të aparatit pedagogjik që shërben si busull që e orienton nxënësin drejt të mësuarit logjik, padyshim ai shërben si pikë referimi edhe për mësuesin. Ky aparat pedagogjik do të jetë ndihmesë në shmangien e sistemit të shumë pyetjeve që e çorinetojnë nxënësin në kapjen e problemeve esenciale, shmang përgjigjet riprodhuese, shmang përgjigjet e thata me “Po” apo “Jo”. Duhet punuar që nxënësi të mos përgjigjet me një frazë të mësuar përmendësh, duhet punuar në shmangien e skolastikës nga mësuesit që kur e kanë thënë se filxhani qëndron mbi pjatë e quajnë gabim nxënësin kur thotë se pjata qëndron mbi filxhan. Apo kur mësuesi për një gotë të mbushur përgjysmë me ujë ka thënë se gjysma e gotës është e mbushur, e quan gabim kur nxënësi thotë se gjysma e gotës është e zbrazur. Meriton studim dhe përgjithësime përvoja e atyre mësuesve që shmangin përdorimin e një modeli, por aplikojnë pyetje që kërkojnë krahasim, pyetje që kërkojnë arsyetim, pyetje që kërkojnë intuitë, pyetje që kërkojnë kundërshtim, pyetje që të ftojnë në studim.

*“Nuk di asnjë kriter më të sigurt për vlerën pedagogjike të mësuesit sesa mënyra e të pyeturit, nuk njoh asnjë arritje të tillë që të zbulojë në mirë e më shpejt ç’grykim, metodë e dije mund të ketë ai”.*<sup>12</sup>

Kam qenë i pranishëm në një orë mësimi historie, dhe mësuesi nuk bëri kurrfarë hyrjeje, por në dërrasën e zezë shkruajti disa pyetje rreth mësimin të ditës si edhe një pyetje nga mësimet e kaluara që kishte lidhje me pyetjet e mësimin të ditës. Listës iu shtuan edhe dy pyetje të ardhura nga vetë nxënësit. U lanë rreth 5 minuta kohë që nxënësit të formulonin përgjigjet duke vështruar edhe në tekstin mësimor dhe jo duke dhënë urdhër kategorik “Mbyllni librat”! Sipas kësaj praktike, u shmangën pyetjet improvizuese apo befasuese që e hutojnë nxënësin dhe iu dha mundësia të gjejnë përgjigje të thelluara e të menduara. Ua rekomandova këtë përvojë edhe mësuesve të tjerë, dhe atyre të lëndëve fetare, duke organizuar edhe një mësim të hapur te ky mësues me të njëjtin model.

*“Të pyeturit e ndërsjellë është një ushtrim kolektiv që konsiston në hetimin e një pyetjeje të caktuar bashkërisht duke propozuar përgjigje në formë hipotezash, duke zhvilluar ose modifikuar në*

11 Grup autorësh: “Aspekte të mësimdhënies”. Te pyetësorët anglisht: Kualida, botim 1999, faqe 6.

12 “Kur arsimit kërkonte shpëtim”. Tiranë, 2002, faqe 53.

*sajë të pyetjeve të përshtatshme dhe duke i krahasuar këto përgjigje të ndryshme mes tyre për të nxjerrë prej tyre pikësynime më të qenësishme”.*<sup>13</sup>

Të mësuarit nëpërmjet pyetjeve nuk është shkopi magjik që bën mrekulli në procesin mësimor. Nëse kjo metodë kthehet në proces monoton, pushon të qenit nxitës në të menduarit e nxënësve. Nxënësin nuk e lodh mësimi, por monotonia e mësimit. Monotonia thyhet dhe krijohen variacione që freskojnë dhe gjallërojnë aftësitë dhe zellin e nxënësit në mësim. Në një seminar, vite më parë, ndoqa me vëmendje përvojën e një mësuesi gjeografie, i cili me sa mbaj mend theksoi se krahas kontrollit nëpërmjet pyetjeve logjike, e kombinonte këtë metodë me teste kontrolli, me përgatitje grafike, me përgatitje hartash, me lexime gjeografike, me udhëtime imagjinare. Njëra metodë është e ndryshme nga tjetra, por finishin e kanë të përbashkët. Mësuesi që referoi kishte goxha përvoja pozitive dhe iu përgjigj me kënaqësi kërkesës për të zhvilluar një bashkëbisedim me mësuesit e medresesë. Ky bashkëbisedim ishte jo vetëm një provë e epërsisë së përgjithshme të përvojës pozitive mbi të gjitha metodat e përdorura prej tij, por njëkohësisht nxiti përgjithësimin e përvojës pozitive të nxënësve ekselentë mbi nxënësit e tjerë. Në kujtimet e tyre, ish-nxënës të Medresesë së Përgjithshme të Tiranës shkruajnë për ish-nxënësit më të mirë të kësaj shkolle që ndihmonin nxënësit me rezultate më të ulëta, si në lëndët fetare ashtu edhe në ato laike.

Kjo metodë është e zbatueshme dhe aktuale në medresetë tona, duke hapur një kapitull të ri në fushën e didaktikës, duke e vështruar nxënësin jo vetëm si mësimnxënës por edhe si mësimdhënës. Në kontrollin e njohurive të nxënësve ka vend përdorimi i metodës së konkursit mësimor, për të cilën nuk mund të jepen receta, sepse mund të përdoret si në lëndët laike ashtu edhe në lëndët fetare. Konkursi nuk duhet kuptuar e zbatuar si një moment ku nxënësit vihen në garë përballë pyetjeve që kërkojnë përgjigje verbale. Me interes janë ato forma konkursi ku nxitet dhe vihet në garë aktiviteti i pavarur dhe krijues. Këto standarde i plotëson një konkurs i në fushën e historisë. P.sh.: Cilat janë ngjarjet më madhore në historinë e popullit shqiptar? Mund të jetë Kuvendi i Lezhës, mund të jetë Lidhja Shqiptare e Prizrenit, mund të jetë Shpallja e Pavarësisë, mund të jetë Kongresi i Lushnjës, mund të jetë Çlirimi i Shqipërisë.

Metoda e përdorur e konkursit, në lëndën e gjeografisë me temën “Përshtypje e një udhëtimi nëpër Shqipëri”, tregoi se njohuritë e marra

13 Oscar Brenifier. “Të mësosh nëpërmjet debatit”, faqe 53.

në këtë lëndë krijojnë mbresa e ndjenja në botën shpirtërore. Në lëndën e letërsisë, konkursi mund të jetë krijimi i një proze apo poezie. Në lëndët fetare gjithashtu mund të përdoret metoda e konkursit, veçse për të duhet të vrasin mendjen vetë mësuesit e këtyre lëndëve. Vite më parë, Drejtoria Arsimore e Komunitetit Mysliman organizonte konkursin e Kuranit midis medreseve të Shqipërisë. Për të nxjerrë përfaqësuesin tonë, zhvillohej konkursi brenda shkollës. Theksoj se ky konkurs ishte hap cilësor në përvetësimin e Kuranit. Metoda e konkursit në mësim ndihmon në analizën dhe sintezën e njohurive të fituara nga nxënësit, sepse kjo metodë e ushtron nxënësin në analizë, në thellim, në kuptim të njohurive që ka fituar, që do të thotë është ngjitje në shkallën e të kuptuarit të dijeve si kërkesë a didaktikë bashkëkohore. Edhe pyetjet enigme me mundësi zbatimi si në lëndët humane dhe ato fetare, ndihmojnë në ngulitjen dhe sistemimin e njohurive. Enigma është e mbyllur në zarf, mbi tavolinë, me emrin e nxënësit.. Nxënësi duhet duhet ta gjejë përgjigjen me 10 pyetje. Po e konkretizoj me një shembull nga lënda e Gjeografisë: Mësuesi vendos mbi tavolinë një letër të palosur. Nxënësi pyet: - A është emër mali? -Jo. - A është emër lumi? -Jo. - A është emër vendi (qendër e banuar)? - Po. - A ndodhet në veri të Shqipërisë? -Po. - A është Shkodra? -Jo. - A është Kukësi? -Jo. - A është Rrësheni? -Jo. - A është Tropoja? -Jo. - A është Bajram Curri? - Po. Kuptohet që ajo çka shënohet në pyetjen-enigmë duhet të ketë peshë në bagazhin e njohurive dhe nuk mund të jetë p.sh. :emri i fshatit Cepaj të Skraparit. Këtë emër fshati nuk do e gjente nxënësi jo me 10, por as me 100 pyetje.

## Përsëritja është nëna e dijes apo babai i mërzitjes?

Kjo pyetje qarkullon në qarqe pedagogësh, psikologësh, didaktësh, mësuesish, dhe mbetet pezull tradicionalisht. Sipas këshillës së një pedagogu ne përsëritjen e kemi quajtur nëna e dijes dhe këtë slogan e citon çdo mësues. Ndërsa Prof. Dr. Tahir Zajazi në librin e tij “Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies” shkruan:

*“Provat tregojnë se shumica e nxënësve përsëritjen nuk e pranojnë me dëshirë. Madje edhe për nxënësit e mirë përsëritja është e mërzitshme, sepse ndodh një riprodhim monoton i koncepteve të mësuara më parë”.*<sup>14</sup>

14 Prof. Dr. Tahir Zajazi. Libri: “Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies”. Shkup, 2003, faqe 345.

Shqetësimet e këtij autori janë “vëth në vesh” për mësuesit, sesi nuk duhet zhvilluar përsëritja. Që ajo të mos jetë një riprodhim monotoni i njohurive që nxënësit kanë marrë në një kapitull mësimor apo në një temë mësimore. Në organizimin e përsëritjes mësuesit duhet të kenë si moto një fjalë të mençur popullore “Ndaji kokrrat e gurët nga kashta”, që do të thotë se si në përsëritjen paralele ashtu edhe në përsëritjen e përgjithshme mësuesi duhet të rrotullohet rreth atyre njohurive që janë thelbësore dhe që përbëjnë fondin e artë në bagazhin e njohurive të nxënësve. Mësuesi duhet të aftësojë nxënësit të kërkojnë për të gjetur lidhjet midis njohurive të reja dhe atyre të mëparshme. Kur shpjegon një temë të re mësuesi duhet të përpiqet të zbulojë se çfarë mund të dijë nxënësi rreth saj. Në shpjegimin e temës “Pashallëku i Bushatllinjve” mësuesi i historisë i nxiti nxënësit të bënin krahasim midis Mehmet pashë Bushatlliu dhe Ali pashë Tepelenës. Ai i orientoi që të gjenin ngjashmëri të shkaqeve, të veprimeve dhe luftërave të tyre, të sukseseve dhe shkaqet e dështimit të këtyre dy pashallarëve në luftë për t’u shkëputur nga Turqia. Në mësimin përgjithësues rreth kapitullit “Rilindja Kombëtare Shqiptare”, mësuesi temat e këtij kapitulli i kishte grupuar në dy problematika: Arsyeto për ngjarjet madhore të Rilindjes Shqiptare përveç atyre që ke lexuar në tekst, si dhe prezanto ndonjë informacion marrë nga burime të ndryshme informacioni e veçanërisht nga kompjuteri dhe internet. Siç shihet në këtë mësim përgjithësues, mësuesi i është larguar pyetjeve që kërkonin riprodhim të njohurive që përmbante teksti. Duke u rrotulluar rreth problematikave, nxënësit gërmuan në mendimin e tyre logjik. Nëpërmjet punës kërkimore nxënësit theksuan se në këtë kapitull nuk shkruheshin as dy rreshta për Hoxha Tahsimin, të cilin vetë Sami Frashëri e quan mësues të vendasve. Në krijimtarinë e Sami Frashërit mungojnë në libër veprat: “Heronjtë e Islamizmit”, “Përhapja e Islamit ndër shqiptarët dhe Qytetërimi Islam”. Në krijimtarinë poetike të Naim Frashërit, vargjet ku shkruhet për Zot dhe Perëndi janë zëvendësuar me pika. Nga vepra e Naim Frashërit nxënësit recituan poezi që dikush i dëgjonte për herë të parë. Në këtë orë mësimi ishte i pranishëm edhe një mësues i lëndëve fetare. Asnjë vlerësim me notë në këtë mësim, duke kënaqur nismën e nxënësve se mësojnë për jetën dhe jo për dhjetën. Bankat ishin vendosur në formë të rrumbullakët dhe pozicioni i mësuesit nuk ishte në katedër, por përkrah nxënësve. Mësimi u zhvillua në dy orë, duke rezervuar kohë të mjaftueshme për diskutim dhe debat mësimor. Kam asistuar gjithashtu në një orë mësimi përgjithësuese në letërsi, me temë “Figurat letrare”. Mësuesi i kishte porositur nxënësit se mësimi do

të zhvillohej me figura letrare të gjetura nga nxënësit në përditshmërinë e jetës së tyre, jo nga ato të librit. Nxënësit sollën shembuj figurash letrare, krahasime, hiperbola, metafora, metonimi, krejtësisht origjinale. Ora e mësimit mori formën e një konkursi për përcaktimin e figurës letrare më të bukur, me votim të fshehtë. Konkursin e fitoi krahasimi: “Mësuesit tonë të letërsisë i rrjedhin fjalët si ujërat e lumit Osum”. Është folur dhe shkruar për t`u përdorur si formë e përsëritjes edhe udhëtimi imagjinar. Mësuesi i gjeografisë ka hapësira për të bërë një udhëtim imagjinar me helikopter nëpër bjeshkët e Shqipërisë, duke u nisur nga lartësia 2751 m e malit Korab e duke udhëtuar në 20 majat e larta mbi 2000 m lartësi në Jezercë, Tomor etj. Nga majat e këtyre maleve ata mund të flasin për qytetet që shohin, për florën, për faunën që ndeshin, për ujërat që rrjedhin faqeve të maleve, për freskinë që ndjejnë në këto maja. Po kështu në lëndën e gjeografisë, me interes është një udhëtim imagjinar me varkë duke filluar nga lumi Drin, e duke vazhduar udhëtimin nëpër Vjosë, Shkumbin, Osum, Seman e Devoll, Bunë e Mat, që nga vendburimi dhe deri në grykëderdhjen e tyre. Pra, duhet që nxënësit të lihen të lirë që të flasin për vendet, për fushat, dhe për qytetet ku do të kalojnë. Mendoj se një përsëritje e tillë kapitulli, me thyerje dhe variacione, jo vetëm nuk do të jetë e mërzitshme, por do të jetë shumë e bukur dhe interesante për nxënësit. Udhëtime imagjinare mund të kryhen në lëndën e historisë islame, për të përshkruar vendet ku u përhap islami, të cilat janë në pesë kontinente. Nxënësit do të ndeshen me qytete të mëdha, me xhami të bukura, me biblioteka dhe universitete që lulëzuan në mjediset islame, madje mund të shkojnë deri në Alaskën e akullt e të vizitojnë atje qendrën komunitare islamike, dhe të gjejnë duke u falur jo vetëm 3000 myslimanët e asaj zone të ardhur nga Europa, por edhe indigjenë.

## Më shumë rëndësi për ne ka jo çfarë mësuesit na mësojnë, por si na mësojnë të mësojmë

Kështu u shprehën disa nxënës në një anketë ku u kërkohej mendimi rreth punës së mësuesve të tyre. Kjo do të thotë se nxënësit kërkojnë prej mësuesve që të mësohen si të mësojnë, si të përdorin tekstin mësimor, si të kryejnë detyrat, si t`i përgjigjen pyetjeve, e një kompleksitet çështjesh që plotësojnë kuadrin e metodave të të nxënës. Nxënësit ndeshin edhe vështirësi gjatë përgatitjes për mësim, sepse nganjëherë nuk arrijnë të kapin e të përqendrohen në dijet thelbësore.

*“Futja e një metode të re në procesin mësimor pasuron metodat e të nxënësve të nxënësve. Mënyra si mësuesi e ndërton orën e mësimin, se si shpjegon, se si paraqet dhe zgjidh problemin, se si ua jep në përgjithësi nxënësve njohuritë, këto e të tjera janë dhe duhen bërë gjithmonë e më mirë modele për nxënësit që edhe ata të ecin nëpër këto rrugë gjatë të nxënësve apo gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të pavarura që u jepen”.*<sup>15</sup>

Këshilla praktike sesi nxënësit duhet të mësojnë, shkruante dikur Hakai Sherafi. Në kushtet aktuale mund ta rimodelojmë dhe ta zëvendësojmë nocionin “këshilla” me nocionin “udhëzime për nxënësit” në mënyrë që këto këshilla të mos mbeten thjesht leksione mbi metodat, por të jenë si një guidë për nxënësit, që ai të mbajë shënime kur shpjegon mësuesi, në mënyrë që të dëgjojë për të kuptuar, pra të dijë të dëgjojë. Nxënësi gjatë kohës që lexon një libër duhet të mbajë lapsin në dorë për të nënvizuar çështjet më kryesore sipas specifikave të lëndëve dhe temave mësimore, që do të thotë të lexojë për të mësuar. Në përmbyllje të procesit të të mësuarit, nxënësi duhet të shkruajë diçka shkurtimisht rreth asaj që lexoi, sepse shkrimi sistemon mendimin. Në lëndët humane zbatohen praktika të nxënësve njohurish jashtë kornizave të teksteve mësimore.. Në këto lëndë nxënësit i gjejnë të angazhuar në shfletime librash jashtë klase si dhe në kërkim informacionesh në internet në sinkron me temën aktuale. Nxënësit në këto lëndë i gjejnë gjithashtu të angazhuar në përgatitje referatesh e skenarë të ndryshëm shkrimesh, ku shpalosen aftësitë krijuese. Nxënësit e klasave të larta të medresesë së Beratit, angazhoheshin në përgatitjen e hytbeve që mbanin në xhaminë e qytetit apo në xhamitë periferike. Shembujt e mësipërm dëshmojnë për efikasitetin dhe shumëllojshmërinë e metodave të nxënësve. Metodot e mësimdhënies dhe nxënësve janë aq shumë dhe në vijimësi, si paralelet mbi të cilat ecin treni.. Në këtë tren udhëtojnë së bashku mësues dhe nxënës.

### ***Bibliografia***

1. Prof. Dr. Ramiz Zekaj. “Edukata fetare e morale në tekstet shkollorë të Haki Sharafit”. Libri Haki Sharafi dhe vepra e tij, Tiranë, 2000, faqe 71.
2. Ismail Muçaj. “Çfarë di dhe zotëroj nga gjuha dhe letërsia e kam

15 Agim Polovina, “Revista pedagogjike” Nr. 4, 1980, faqe 41.

- prej profesorit të nderuar Haki Sharafi”. Libri Haki Sharafi dhe vepra e tij, Tiranë, 2000, faqe 77.
3. Kol Tahiri, Zana Gjeçi. “Revista pedagogjike” Nr. 9, 1998, artikulli: “Të mësuarit problemor, mjet dhe rrugë efektive në luftë kundër të mësuarit mekanike pasive”, faqe 47.
  4. Telemak Xhaxho, Ylli Pango. “Revista pedagogjike” Nr. 3, 1998, faqe 42. Artikulli: “Për një konceptim më të drejtë te rolet e të menduarit logjik, krijues, në procesin për përvetësimin aktiv të njohurive”.
  5. Prof. Dr. Shefik Osmani “Revista pedagogjike” Nr. 2, 1980, faqe 57. Artikulli “Didakti ynë Aleksandër Xhuvani dhe didaktika shqiptare”.
  6. Prof. Dr. Naser Ramadani. “Kurrikulat dhe tekstet shkollore në medresetë shqiptare”, Tiranë, 2018. Artikulli: “Metodat e mësimdhënies midis traditës dhe modernes në medresenë “Isa Beu”, Shkup, faqe 121.
  7. Luan Harago, Pëllumb Gace. “Revista pedagogjike” Nr. 3, 1988, faqe 29. Artikulli: “Probleme psiko-pedagogjike të të mësuarit aktiv krijues”.
  8. Vilson Kuzi. “Revista pedagogjike” Nr. 3, viti 1978, faqe 99. Artikulli: “Ngritja e nivelit shkencor të mësimdhënies së historisë e gjeografisë kërkon metoda efikase”.
  9. Prof. Dr. Shaban Sulejmani, Dr. Argëtim Saliu, Mr. Sci. Salim Sulejmani. “Kurrikulat dhe tekstet shkollore në medresetë shqiptare”, Tiranë, 2018. Artikulli: “Kurrikulat e lëndëve fetare islame”, faqe 111.
  10. Dr. Bashkim Peçi. “Administrimi dhe menaxhimi i arsimit”, Tiranë, 2004. Artikulli: “Teoritë dhe metodat e të mësuarit”, faqe 41.
  11. Grup autorësh. “Aspekte të mësimdhënies”. Te pyetësorët anglisht: Kualida, botim 1999, faqe 6.
  12. “Kur arsimi kërkonte shpëtim”. Botim Tiranë, 2002, faqe 53.
  13. Oscar Brenifier. “Të mësosh nëpërmjet debatit”, faqe 53.
  14. Prof. Dr. Tahir Zajez. Libri: “Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies”, Shkup, 2003, faqe 345.
  15. Agim Polovina. “Revista pedagogjike” Nr. 4, 1980, faqe 41.